

**Prishtinë, 31 maj 2007**  
**Kodi i ZRRE-së: D\_50\_2007**

## **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

### **Duke marrë parasysh:**

1. Mandatin ligjor që i jepet në Nenet 45 deri në 48 të Ligjit Nr. 2004/09 "Mbi Rregullatorin e Energjisë";
2. Dispozitat e Rregullit mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike ("Rregulla e Çmimeve"), nxjerrë nga Bordi i ZRRE-së më 15/12/2005, dhe në veçanti pikat 30.2 a) & b) të rregullit të sipërpërmendur;
3. Dispozitat e Metodologjisë së Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike, nxjerrë nga Bordi i ZRRE-së më 15/12/2005;
4. Të dhënat e reja të dërguara nga KEK Sh.a lidhur me zvogëlimin e kostove aktuale për vitin 2007 nën ato të lejuara, sipas Vendimit D\_29\_2006 të datës 21/12/2006 mbi "Të hyrat e Lejuara për KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a për periudhën e rishqyrtimit të çmimeve 2007-2009".
5. Vendimin D\_47\_2007 të datës 07/05/2007, lidhur me të dhënat e reja, për rishqyrtimin e të hyrave të lejuara për KEK Sh.a, të miratuara në Vendimin D\_29\_2006;
6. Nevojën që ka pasuar që gjithashtu të rishqyrtohet edhe Vendimi D\_39\_2007 i datës 15/03/2007 "Mbi miratimin e tarifave të reja me pakicë për KEK Sh.a";
7. Komentet e pranuar gjatë rishqyrtimit, duke përfshirë propozimin e parashtruar nga KEK Sh.a për ndryshimin e tarifave me pakicë të aprovuara, si dhe qëndrimin e ZRRE-së për këto propozime.

### **Bordi i ZRRE-së në Sesionin e mbajtur me 31 maj 2007, ka vendosur të:**

1. Ndryshojë Vendimin D\_29\_2006 të datës 21/12/2006 mbi "Të hyrat e Lejuara për KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a për periudhën e rishqyrtimit të çmimeve 2007-2009" siç shihet në tabelën më poshtë, për të përshtatur të hyrat e lejuara për KEK Sh.a, që do të marrë parasysh të dhënat e reja mbi kostot aktuale të reduktuara të ofruara nga këto kompani:

**Tabela 1: Të hyrat e lejuara të ndryshuara për KEK Sh.a, 2007**

<i>EUR 000</i>	<i>Miratuar (21 dhjetor 2006)</i>	<i>të ndryshuara</i>
Të hyrat e lejuara që duhet të mbulohen nga tarifat me pakicë të rregulluara për vitin 2007	141 899	134 982

2. Në përputhje me rrethanat, ndryshohet Vendimi D\_39\_2007 i datës 15/03/2007 “Mbi Aprovimin e Tarifave të Reja me Pakicë për KEK Sh.a-në” për të miratuar tarifatat me pakicë si vijojnë në Tabelën 2:

**Tabela 2: Tarifatat e ndryshuara me pakicë për KEK Sh.a**

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Aprovuar	
					Sezona e lartë 1 tetor - 31 mars	Sezona e ulët 1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		519.00	519.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.03	1.78
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.50	1.47
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		30.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		540.00	540.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.30	2.73
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.33	2.47
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		466.00	466.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.07	3.15
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.81	2.87
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzim të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		29.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		270.00	270.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.85	4.36
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.95	4.11
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	9.68	6.26
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	11.64	7.63
			€/kWh	Tarifa e ulët	5.82	3.81
5	0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh) shtëpiak b)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00	
		<200 kWh/muaj (Blloku i parë)	€/kW		0.00	0.00
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë)	€/kW		0.00	0.00
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë)	€/kW		0.00	0.00
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.42	3.17
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.21	1.58
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	5.97	4.28
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.99	2.14
6	0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh) shtëpiak b)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00	
		<200 kWh/muaj (Blloku i parë)	€/kW		0.00	0.00
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë)	€/kW		0.00	0.00
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë)	€/kW		0.00	0.00
		<200kWh/muaj (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifa e vetme	3.94	2.82
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifa e vetme	5.32	3.81
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë)	€/kWh	Tarifa e vetme	7.72	5.53
		7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <400kWh/muaj	€/konsumator/muaj	
Konsumi i vlerësuar 400-800kWh/muaj	€/konsumator/muaj				36.00	
Konsumi i vlerësuar >800kWh/muaj	€/konsumator/muaj				61.00	
8	Ndriqimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00	
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë)	€/kWh	Tarifa e vetme	7.82	7.82

a Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00-22:00 gjatë sezonës së lartë dhe prej 08:00-23:00 gjatë sezonës së ulët

b Konsumatorët e regjistruar si raste sociale ngarkohen me normë zero për nivelin e lejuar nga qeveria

c Konsumatori ngarkohet me energji reaktive të shpenzuar mbi atë të lejuar,  $\cos \phi = 0.95$

3. Tarifatat e reja me pakicë do të zbatohen nga data 1 maj 2007, dhe për KEK Sh.a do të parashihet mundësia që pas 31 dhjetorit 2007, për pajtueshmëri ndërmjet shumave që aktualisht merren nga konsumatorët dhe atyre që do të merreshin nëse tarifatat e reja do të

hynin në fuqi nga data 1 prill 2007, dhe ndryshimi t'ju shtohet apo zbritet konsumatorëve gjatë vitit 2008, në mënyrë që të propozohet nga KEK Sh.a dhe të miratohet nga ZRRE-ja.

4. Ky Vendim do të publikohet nga KEK Sh.a. brenda 5 ditëve të punës, së paku në një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë, pas njoftimit të ZRRE-së dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të saj.
5. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
7. Ky Vendim do të zbatohet nga data 1 maj 2007.

Mbështetja për këtë vendim është dhënë në letrën përcjellëse (Rishqyrtimi i vendimeve D\_29\_2006, D\_39\_2007 dhe D\_41\_2007).

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Dr. Ali Hamiti  
Kryesues

---

Theranda Beqiri  
Anëtare

---

Nysret Avdiu  
Anëtare

---

Merita Kostari  
Anëtare

---

Naim Bejtullahu  
Anëtar

*Kopje:*

*Kryetarit të Kuvendit  
Kryeministrit;  
MEM-it;  
ZPSSP Shtyllës së IV;  
Zyrës për Politikë Ekonomike / Shtylla e IV;  
Zyra Ligjore / Shtylla e IV;  
KEK Sh.a  
MEF-it;*

*Zyrës për Çështje Fiskale/ Shtylla e IV;*